



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavuke

ZL.Anr.228/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Gyltene Sylejmani dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Kudret Hasani, duke vodusur përkitazi me ankesën e Rrjetit Ballkani për Gazetari Hulumtuese - BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) me seli në Prizren, për shkak shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, për Zgjedhjet Lokale që do të mbahen me datë 22.10. 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 18.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Rrjetit Ballkanik për Gazetari Hulumtuese (BIRN) dhe INTERNEWS KOSOVA, me seli në Prishtinë, subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP), i shqiptohet dënim i më gjobë në vlerë prej 2,200,00 (dymijë e dyqind) euro, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e Tyre dhe Kandidatët, të cilën gjobë detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të këtij vendimi nën **kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

PZAP më datë 17.10.2017, ka pranuar një ankesë nga Rrjeti Ballkanik për Gazetari Hulumtuese - BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA me seli në Prishtinë, me të cilën pretendon se subjekti politik KTAP në vazhdimësi përmes rrjeteve sociale ka shpërndarë spotin politik në të cilën janë përdorur pamje të objekteve fetare, dhe pamje të brendshme dhe të jashtme te kuvendit komunal të Prizrenit si dhe pamjet e brendshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës. Parashtuesi i ankesës thekson se në këtë spot të publikuar pos objekteve fetare dhe objektit te kuvendi komunal, ka edhe përdorim të fëmijëve. Këto veprime të subjekti politik KTAP bien ndesh me nenin 5.2 të Rregullës zgjedhore 13/2013 si dhe me nenin 5.2 , dhe 35.1 të Ligjit për Zgjedhje et Përgjithshme (LZP), andaj ka propozuar që ankesa të provohet.

Në mbështetje të pretendimeve ankimore ka bashkangjitur një CD, me video promovuese të shpërndarë nga facebook i subjektit politik KTAP.

Në përgjigjen në ankesë të subjekti politik KTAP, të datës 18.10.2017, thekson se asnjë nen i ligjt nuk e parasgeh se është e ndaluar shfaqja në video klipe e objekteve fetare apo shfaqja e

ezanit, ku me këtë veprim parashtruesi i ankesës ofendon ndjenjat fetare të myslimanëve. në klipin pasi që nuk ekziston asnje element i cili dëmton dhe shkel fushatën zgjedhore. I njëjtë kërkon nga PZAP-i që ankesa e bërë ndaj tyre nga BIRN ta refuzon.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

Ankesa është e bazuar

Paneli nga CD e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës e cilat gjendet në shkresat e lëndës, ka vërtetuar se subjekti politik KTAP, për qëllime elektorale ka publikuar video spotin të cilin edhe e ka shpërndarë nëpërmjet rrjetit social facebook të subjektit politik në fjalë ku shihet se i njëjti në video spot ka përdorur përfundimisht fushatë zgjedhore objektet publike dhe fetare të nivelit qendror dhe lokal me qëllim të promovimit të subjektit politik KTAP dhe të kandidatëve të saj për tu votuar në zgjedhjet lokale të 22.10.2017.

Nga dëshmitë e sipërcituara paneli në mënyrë të sigurt dhe padyshimtë, ka vërtetuar se nga subjekti politik KTAP, janë bërë shkelje të Kodit të Mirësjelljes për Subjekte Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, nga fakti se, publikimi i video spotit të tillë, paraqesin veprime të sanksionuara me dispozitën e nenit 35.1 të LZP-së i cili përcakton qartë se *personi që mban pozitë publike, i zgjedhur apo i caktuar, nuk mund të përdorë atë zyre ose ndonjë nga pasuritë e saj me qëllim të përfitimit të votave. Asnjë nga burimet e asnjë institucioni të administratës publike, ose edhe ndonjë ndërmarrje në zotërim ose të kontrolluar nga autoritetet qendrore ose lokale nuk mund të shfrytëzohen ose të futen në mbështetje të ndonjë subjekti politik në zgjedhje. Po ashtu edhe dispozitën e nenit 5.2 të rregullës Zgjedhore 13/2013 Fushata e Zgjedhjeve dhe njoftimi për ngjarjet politike e cila përcakton qartë se, në fushatën e zgjedhjeve të asnjë subjekti politik të certifikuar nuk mund të përfshihen kategoritë e punësuarve në institucionet shtetërore dhe publike, organizatat bamirëse dhe fetare, përfaqësuesit e bashkësive fetare, si dhe personat të cilët nuk i kanë mbushur 18 vjet në ditën e zgjedhjeve.*

Nga arsyet e theksuara më lartë, ankesa e parashtruar nga BIRN dhe INTERNEWS KOSOVA, u miratua si e bazuar pasi që pretendimet në ankesë janë të bazuara në fakte bindëse ku vërtetohet se subjekti politik KTAP ka bërë shkeljen e Kodit të Mirësjelljes të pëershkuar si më lart, Paneli vendimin e tij e mbështeti në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, prandaj pretendimet në përgjigje në ankesë nuk u cilësuan me ndikim në meritat e lëndës.

Parashtrimet në përgjigje në ankesë, se veprimet e subjekti politik KTAP nuk paraqesin shkelje dhe nuk mundë të sanksionohen si shkelje e Kodit të Mirësjelljes, për arsy se me asnjë nen nuk ndalohet shfaqja në video spote e objekteve fetare apo shfaqja e ezanit, Paneli pretendimet e tillë i vlerësoj si të pa bazuara dhe si të tillë i refuzoj pasi që me këto veprime të subjektit politik janë të ndaluara dhe në kundërshtim me dispozitën e Nenit 35.1 të LZP-së, si dhe nenit 5 paragrafi 2 të Rregullës 13/2013, ku parashihet se subjektet e certifikuara politike aktivitetet e tyre zgjedhore duhet t'i bëjnë ne pajtueshmëri me Rregullat zgjedhore te

Komisionit Qendoror Zgjedhor (KQZ), dhe Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme. Në fakt Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit .

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rr Ethanat për rastet: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin së KTAP-ja, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, që do të thotë se i njëjtë është i njoftuar me rregullat zgjedhore, si dhe shumën e fonave që ka marra subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur më fushatën zgjedhore. Po ashtu si rr Ethanë, PZAP-i, mori edhe faktin që këtij subjekti, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjet e tij ka mohuar shkeljet e supozuara.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pikë c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Zl.Anr. 228/2017 më datën 18.10.2017

Kryesuesi i Panelit
Adnan Konushevci



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.